



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 25 qershor 2025 , në mbledhjen e XXXVI-të (tridhjetegjashtë) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10:10.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; (Naim Çunaku; Ekrem Rrahmani; Arnisa Sylejmani; Haki Rudari; Sebastina Vokri; Bashkim Sylaj; Mrika Thaçi) bashkëngjitur lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje e pranishëm ishin edhe; Marigonë Lahu Nënkrjetare e Komunës; Fatlum Osmani drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave DBF; Saranda Stublla drejtoresh e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë DPKGJ; Lirie Hoti drejtoresh e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR.

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, konstatoi kuorumin, ndër të tjera theksoi, për momentin z.Ekrem Rrahmani mungon dhe pritët të vijë ndërsa nga Lëvizja Vetëvendosje mungon një anëtar sepse ende nuk është zgjedhur anëtar i ri.

Sa i përket rendit të ditës besoj që e keni marrë të gjithë, ku kemi pesë pika, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën lidhur me rendin e ditës.

znj.Lirie Hoti, drejtoresh e DBPZHR, theksoi, përshëndetje për të gjithë, atëherë propozimi im është shtimi i një pike të re në rendin e ditës për seancën e cila do të mbahet ditën e nesërme, ku kjo pikë ka për qëllim kompensimin e dëmit të shkaktuar në pronën e një fermeri, më saktë znj.Albana Hoxha e cila është dëmtuar në fushën e saj të mbjellur me çarshia për çka raportin e vlerësimit e kemi pranuar nga komisioni për vlerësimin që e ka bërë në teren sipas shuma për kompensim është 19,550.00€, ndërsa unë propozoj që në bazë të mundësive financiare që kemi t'i bëhet një kompensim prej 11,000.00€ e që natyrisht që nesër në mbledhjen e Kuvendit do t'ju prezantohet lënda për këtë rast dhe me qëllim që të keni kohë për të parë lëndën do të propozoj që kjo pikë të jetë në fund të rendit të ditës pasi të shqyrtohen pikat e tjera.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse dëshiron të marr fjalën ndokush lidhur me këtë pikë që u propozua për rend të ditës.

z.Haki Rudari, theksoi, për momentin abstenoj sepse nuk kam material për këtë pikë të rendit të ditës, dhe kemi shumë raste tjera nuk janë kompensuar kurse tani vije vetëm një kompensim, për këtë arsyeje kam të drejtën e abstenimit. Do diskutojmë në mbledhje të Grupit dhe qëndrimin tim e jap nesër në mbledhjen e Kuvendit.

z.Naim Çunaku, theksoi, prej kur kemi pas paraqitje për vendimmarrje e në veçanti kur kemi të bëjmë me individ të cilët kanë pësuar dëme të paparashikueshme dhe kur ke parasysh që një pjesë e atyre mjeteve, se dëmi nuk po propozohet ti kompensohet në përputhje 100% por vetëm një pjesë e saj, unë mendoj që për buxhetin e Komunës nuk do të ishte një diçka që do ta rëndon buxhetin e Komunës dhe në vazhdimësi jam Për, që të bëhet kompensimi i qytetarëve dhe në veçanti kur kemi të bëjmë me fermerë grua.

Kjo që e thotë shefi i Grupit të VV vërtetë nëse i qasesh nga ai kënd që e theksoj ai ka shumë të drejtë që bujqit në Komunën tonë janë numër i madh që kanë pasur dëme nga më të ndryshmet por unë do e përmendi një rast ku ju e dini që një fermer ka ardhur disa herë tek ju për dëmin që i është bërë në pula në fshatin Lluga dhe e dini pastaj nëse fillojmë të kompensojmë dëme, andaj këtu pajtohem me zotëri Rudarin që e theksoj që nuk mund të jemi për dikë po e për dikë jo. Sidoqoftë ne duke u bazuar në atë parim që e theksova në fillim që jam për kompensimin e fermerëve cili do qoftë ai, por do të ishte shumë më në rregull që e thotë edhe zotëri Rudari që nëse fillojmë t'i kompensojmë duhet të kompensohen të gjithë, pra kjo ke sa i përket vendimmarrjes pro apo kundër,

Ndërsa sa i përket që ty hyj me urgjencë si pikë e rendit të ditës, nuk dua që të kthehem në fillim të përbërjes së këtij Komiteti ku më shumë së njëherë kemi biseduar që pikat e rendit të ditës duhet të merren seriozisht dhe duhet të jemi të informuar ne si anëtar të Kuvendit se çka po votojmë sepse fundja ajo ndjenja njerëzore më detyron t'i votoj Për, mirëpo ana procedurale vërtetë në demokraci është procedurë dhe ligje, dhe kur do të mësohemi që duhet të veprojmë sipas procedurës dhe ligjit.

z.Bashkim Sylja, theksoi, përshëndetje për të gjithë, pajtohem plotësisht me një pjesë të fjalimit të kolegut parafolës z.Naim Çunaku që kjo mund të bëhet si praktikë edhe në të ardhmen, ku vijnë fermerët individualisht dhe bëjnë kërkesë, mirëpo derisa drejtoresha e DBPZHR e ka sjell si pikë besoj që ka pasur informacione por do të ishte mirë që të na sillte informacione më shume këtu neve me qëllim që të dimë se çfarë po votojmë, përndryshe kjo është vetëm pikë e rendit të ditës ku nesër mund të diskutohet më gjerësisht, pra ka të drejtë të propozoj, por do të duhej të kishte informacione më shumë.

Përndryshe duhet të ketë kujdes sepse bëhet si praktik në të ardhmen ku mund të ketë kërkesa të mëdha sepse ne e dimë se sa fermer gjatë një viti mund të dëmtohen nga fatkeqësitë natyrore. Pra ne këtu sot votojmë vetëm që të hyj si pikë e rendit të ditës, por nesër apo sot mund të marrim informacione më shumë para se të hedhim në votim.

znj.Arnisa Sylejmani, theksoi, sa i përket çështjes lidhur me informatat e komisionit, a mundeni që sot pasi të përfundoj votimit apo kjo mbledhje, të na dërgohet materiali në e-mail.

z.Naim Çunaku, theksoi, në fazat e mëparshme të qeverisjes kemi pasur një fond emergjent, ku është paraparë se nga i cili kod do të paguhet apo kompensohet nëse do të kompensohet kjo shumë dhe a ka mundësi Drejtoria apo a ekziston një fond i tillë, nëse është një fond i tillë dhe meqë nuk është një shumë e madhe e mjeteve a ka mundësi që të mos kaloj përmes Kuvendit. E them këtë duke pasë parasysh subvencionet e që e keni kodin për subvencionimin në bujqësi, pra a ka mundur që përmes këtij kodi të kaloj dhe të mos të sjellët në Kuvend për vendimmarrje.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, edhe unë e kam të paqartë këtë pse kjo pikë nuk ka ardhur më herët sepse ai dëm ka ndodh para 5-6 muajve apo 7-8 muaj më herët.

z.Naim Çunaku, theksoi, problemi është që ndoshta ka ndodhur para 1 viti, mirëpo çfarë kemi faj që deri tani nuk kanë hyrë qershiat në treg dhe tash janë bërë të kërkueshme.

znj.Lirie Hoti, drejtoresh e DBPZHR, theksoi, ju të gjithë po diskutoni për pikën por fjalën nuk po ma kaloni mua. Nuk jam duke u ngutur zotëri Kryesues por po jepni mendime për një diçka që është e fushës sime ndërsa unë jam këtu dhe për këtë kam ardhur t'ju përgjigjem nëse veç dëshironi t'i dëgjoni përgjigjet. Faleminderit për pikat që i përmendët dhe pajtoj pjesërisht me ju, për shkak se është e vërtetë që kemi dëme të vazhdueshme që ju shkaktohen fermerëve nga faktori natyrë dhe faktori njeri si dhe është e

vërtetë që unë jam në kontakt direkt me fermerët dhe mendoj që më mirë se të gjithë ju i di të gjitha kërkesat dhe shqetësimet që i kanë fermerët.

Edhe në rastin e fshatit Lluga që u cek, fermerin e kam takuar dy herë i cili ka pas dëme në pula, kështu që jam e informuar edhe për atë rast dhe është e vërtetë që jo të gjitha mund të kompensohen, mirëpo kjo kërkesë ka ardhur këtu para jush për shkak se është me raport që është dërguar tek unë nga komisioni për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore, pra komisioni e ka marr dhe e ka shqyrtuar këtë kërkesë, mandej kërkesa qenka parashtruar dhe është formulua në këtë formë, (verifikimi i dëmeve të shkaktuara në pronë dhe shqyrtimi i mundësisë për ndihmë financiare nga Kuvendi Komunal i Komunës së Podujevës), kështu që raporti nga komisioni ka ardhur në DBPZHR për rekomandim në Kuvend dhe me këtë arsyeje është sjellë sot kjo pikë para jush, jo pse ne nuk dëshirojmë që t'i shqyrtojmë edhe kërkesat tjera por kjo është sjellë në këtë formë për ta prezantuar në Kuvend, pra kjo është arsyeja pse e kam sjellë dhe pa pasur ndonjë gjë se kush po kompensohet dhe kush është fermeri i dëmtuar.

Pjesa tjetër që u tha që pse kjo shumë është sjellë në Kuvend, ju them se me Rregulloren për subvencione, deri në 5,000,00€ më duket që Kryetari i Komunës ka të drejtë të ndaj mjete pa e sjellë në Kuvend, ndërsa çdo shumë që është më e lartë se 10,000.00€ në Rregullore thuhet që duhet të kalojë përmes votimit në Kuvendin e Komunës. Sigurisht që për gjithë shumën që këta e kanë vlerësuar se është bërë dëm nuk konsideroj që kemi buxhet andaj ne kemi propozuar që të sjellim këtë shumë prej 11,000.00€.

Se a do shndërrohet kjo çështje në praktikë pastaj, mbetet të diskutohet edhe në seancë të Kuvendit gjatë ditës së nesërme, sepse patjetër që kur dëgjojnë fermerët për këtë rast edhe ata të tjerët do të bëjnë kërkesa për t'u kompensuar.

Kryesuesi i Komitetit, pyeti drejtoreshën e DBPZHR që më gjerësisht të ketë informata lidhur me vlerësimin e dëmit në fjalë.

znj. Lirie Hoti, drejtoresh e DBPZHR, duke i'u përgjigjur Kryesuesit, theksoi, për këtë pyetje i mund t'i drejtoni komisionit për vlerësim të kërkesave nga dëmet që janë shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore, sepse ky komision nuk ka të bëjë asgjë me Drejtorin e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Po ashtu edhe buxhetin për Emergjencë është në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe në kuadër të kësaj vepron ky komision i cili është i formuar me vendim të veçantë të Kryetarit të Komunës, andaj DBPZHR nuk ka të bëjë asgjë me të, përveç që e ka një zyrtar të Drejtorisë anëtar në atë komision.

z. Ekrem Rrahmani, theksoi, nuk e di a është e drejtë që ta sjellët dhe ta subvencionojmë fermerin në fjalë të cilin t'ju them të drejtën as nuk e njoh, por ne nëse nuk gabojmë ndoshta më shumë se 1 vit e gjysmë kemi votuar për dëme që kanë ndodhur këtu, pra është fjala për vërsime dhe asnjëri prej atyre personave nuk kanë marr asgjë para, ndërsa ky fermer i vetëm të subvencionohet, nuk e di a do dalim drejtë apo jo.

Ndoshta më mirë ka qenë të vihej këtu fare sepse edhe kur po sjellët në Kuvend vetëm po dalim keq, madje ata fermer edhe kështu po na bëjnë presion duke na thënë përse nuk na keni jap paratë por na keni mashtruar duke na thënë që i keni votuar por nuk na keni jap, pra unë e theksova që nuk e njoh fermerin në fjalë por nuk e di a është e drejtë kjo punë kështu. Mirëpo edhe kërkesa është e dyshimit se si erdh ajo kërkesë këtu e vetme, sepse ka këtu edhe të tjerë që bëhen dëme. Përveç kësaj ju lus që materialin të na e sjellëni sepse komisioni nuk e di se çfarë bënë, por të sjellët raporti i Policisë së bashku me fotografitë, pra jo të sjellët materialin gjysmë sepse dalim keq pastaj. Përndryshe unë për nuk e kam problem se kush është, po të shohë parregullsi, votoj kundër.

znj. Lirie Hoti, drejtoresh e DBPZHR, theksoi, me gjithë respektin nëse e konsideroni që nuk është mirë që të diskutohet në seancë të Kuvendit të Komunës lidhur me këtë pikë, atëherë mos e votoni, nuk kam çfarë të them tjetër, mirëpo nëse kalon në seancë të Kuvendit patjetër që nga komisioni do të kërkojmë që të kompletoj lëndën në mënyrë që të keni mundësi ta shihni edhe ju.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, faleminderit drejtoresh, mirëpo kjo lëndë është dashtë që të vije këtu para 7-8 muaj, madje tani edhe gjurmët e “krimit” janë zhdukur aty, pra që 7-8 muaj ka ndodh dhe është dashtë që komisioni të merret me këtë çështje, kjo sepse qysh e vlerëson sot dëmin mbas 1 viti.

Urdhëroi nëse ka të interesuar tjerë për të marrë fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim që të hyj si pikë e rendit të ditës propozimi i drejtoreshës së DBPZHR që e paraqiti në fillim të kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se nga 8 anëtarët e KPF-së që ishin të pranishëm, vetëm një anëtar votoj dhe atë Për, kurse anëtarët tjerë nuk morën pjesë në votim, kështu që rrjedhimisht nuk kalon propozimi i drejtoreshës së DBPZHR për përfshirjen e pikës shtesë në kuadër të rendit të ditës në këtë mbledhje.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e vë në votim rendin e propozuar të ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri me 8 vota Për, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

1. Korniza Afatmesme Buxhetore - KAB e Komunës së Podujevës për vitet 2026 /2028

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore siç jemi të njoftuar është dokument strategjik që i paraprinë hartimit dhe miratimit të buxhetit për vitin 2026.

Korniza buxhetore ndërtohet mbi bazën e Qarkores së parë buxhetore dhe mbi bazën e asaj Qarkore buxhetore këtu para jush e kemi paraqitur për miratim KAB të Komunës së Podujevës për vitet 2026-2028, pra edhe për këtë jemi të informuar që kjo nuk kthehet në ligj por në ligj kthehet buxheti, mirëpo kjo i paraprinë hartimit të buxhetit, kështu që nuk dua që të zgjas më shumë lidhur me këtë dokument dhe propozoj që të kaloj për diskutim dhe miratim në seancën e Kuvendit Komunal.

z.Haki Rudari, theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028 është dokument i një rëndësie të veçantë ose do të thoja një dokument shumë i rëndësishëm në të cilën parashihen projektet apo prioritetet e të gjitha Drejtorive në këto 3 vite. Natyrisht që ne e kemi shfletuar materialin dhe kemi parë investime që parashihen në Drejtori të ndryshme, andaj në emër të Grupit të LVV e përkrahim për rekomandim në seancë dhe natyrisht që nesër do t'i japim mbështetjen edhe me votë në mënyrë që të kaloj si vendim.

z.Naim Çunaku, theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore është një dokument që i paraprinë buxhetit të Komunës dhe duke i pasur parasysh afatet ligjore, pa hyrë në përmbajtjen e saj dhe si është hartuar kjo Kornizë buxhetore si dhe pa dashtë të lëshohet në përmbajtje të kësaj Kornize se si do të dukej në projektet e Komunës deri në vitin 2026-2028, sigurisht që edhe ne do të votojmë që të kaloj në Kuvend ku vërejtjet dhe sugjerimet tona dhe gjegjësisht se sa është i kompletuar dhe a i ka kaluar fazat të cilat është dashtë si dhe ku e sheh Komunën e Podujevës në vitin 2028, do ta diskutojmë nesër.

z.Bashkim Sylja, theksoi, është obligim ligjor dhe është në afate ligjore dhe unë mendoj që do të ishte mirë që të bëjmë një analizë të Kornizës Afatmesme Buxhetore 2024-2026 se sa janë përmbushur premtimet apo projektet ku kjo qeverisje i ka planifikuar për vitin 2024-2026, përndryshe kjo i paraprinë buxhetit ku zakonisht kur po e votojmë Kornizën drejtori i DBF po na thotë që ju po e votoni Kornizën e nuk po e votoni buxhetin, në një formë po na zë për fjale, por për këtë Kornizë Afatmesme Buxhetore vërejtjet dhe sugjerimet e mia do t'i jap nesër së bashku me ato të tjerat të cilat nuk i keni realizuar.

Sa i përket buxhetit, mendoj që është normale që t'ia lejmë qeverisjes së ardhshme, pavarësisht a jeni ju a po ndonjë subjekt tjetër, t'i bëjnë ata vet planifikimet për vitin e ardhshëm, pra do të ishte më në rregull kjo që e theksova dhe kështu ka funksionuar edhe para 4 viteve, mirëpo dua të përsërisë edhe njëherë që nuk është mirë të na zëni për fjale pastaj duke thënë që ju e keni votuar Kornizën Afatmesme Buxhetore

kurse tani nuk po e votoni buxhetin, kjo është e njëjta dhe të njëjtat projekte janë, por është mirë që edhe të shikohen projektet e parapara në Kornizën Afatmesme të e kaluar se a janë përfunduar ato projekte.

z.Naim Çunaku, theksoi, vërtetë atë që e tha drejtori i DBF-së dhe që e potencoj nga vendi edhe Nënkryetarja e Komunës lidhur me buxhetin, dua të them që jo se buxheti është aprovuar në janar e zgjedhjet kanë përfunduar në muajin tetor, por pa dashtë të sugjeroj në kuptimin që në aspektin logjik që ajo qeverisje e bënë buxhetin dhe e realizon vetë, por kolegut parafolës z.Bashkim Sylës i them që nëse ne jemi ata që dëshirojmë të ndryshojmë pushtetin nuk i'a votojmë buxhetin por e voton qeveria e re kur do të vije në janar me gjasë, mirëpo si fazë e përgatitjes së buxhetit për të kaluar përmes afateve ligjore nuk kemi mundësi pa e kaluar sose deri më 30 qershor është Korniza Afatmesme Buxhetore, ndërsa vërejtjet që bëri kolegu në fjalë, në veçanti në të kaluarën ka qenë praktikë dhe nuk e kam konsultuar Qarkoren e nuk dua të flas me mëdyshje, por a e ka marr mundin të paktën ky Komiteti për Politikë dhe Financa të jetë pjesëmarrës e organizoj një debat me qytetar sepse ky Komitet vendos për buxhetin, kurse nuk dua të flas se sa kanë qenë qytetarët pjesëmarrës në përgatitjen e kësaj Kornize dhe pse nuk kanë marr pjesë.

Sigurisht që ne e dimë që fjala më e lehtë është, nuk ka interesim nga qytetarët, mirëpo mos të harroni që në mbledhjen e kaluar e kemi miratuar një Rregullore për transparencë komunale, pra mos harroni që e kemi të paraparë me Ligj dhe Udhëzim Administrativ për konsultime dhe standarde minimale të konsultimit publik, pra kemi çaluar dhe jemi larg atyre, por numrat po e bëjnë të vetën.

Edhe z.Haki Rudari e theksoj që nesër mund të votoj edhe ndokush tjetër, por të shohim sepse në vitin e kaluar dikush ka votuar por ka votuar shkak i projekteve e në veçanti projekti për kanalizimin që ka qenë gjegjësisht kolektorin e ujërave të zeza, pra ai ka qenë një prej arsyeve që kemi votuar sepse është segment që e rëndon shumë jetën e qytetarit.

z.Bashkim Sylë, theksoi, është e vërtetë që Korniza Afatmesme Buxhetore është në përputhje me ligjin dhe afate kohore, mirëpo ju e dini që kërkesat që i kam pasur kanë qenë kërkesa publike edhe është e vërtetë ajo që buxhetin duhet të miratohet më herët sepse zakonisht buxheti çdo vit po rritet, kështu që nëse miratohet janar apo shkurt do të ishte problem që të shfrytëzohen të gjitha. Unë gjithmonë kam qenë Për, buxhetin që të mos kthehet në suficit sepse kemi nevojë dhe shumë kërkesa të qytetarëve, mirëpo unë nuk e di në fshatin Gllamnik a ka pasur ndonjë kërkesë dhe unë kam kërkesë për fshatin Gllamnik, por do të ishte mirë që të trajtohet rruga "Ulpiana 41" sepse është rrugë që është ndërtuar shumë herët dhe e dimë të gjithë se kur është ndërtuar pra është bashkëfinancim në mes Komunës dhe qytetarëve ku ne kemi jap fonde, pra është rrugë shumë e rrezikshme dhe e ngushtë për të vozitur në atë rrugë, prandaj tani e kam kërkesë dhe publikisht e them që do ta votoj edhe Kornizën Afatmesme Buxhetore por edhe Buxhetin nëse ju ndani mjete për tu zgjeruar ajo rrugë.

Ju e dini që asnjë kërkesë personale për veten time që 8 vite që jam anëtar i Kuvendit nuk e kam pasur, vetëm për interesa të qytetarëve dhe e dini që ne me qeverisjen Lëvizjen Vetëvendosje e kemi përfunduar afër dy vite më parë. Pra e përsërisë, nëse e projektoni dhe ndani mjete për atë rrugë unë publikisht e them që vota ime është Për, qoftë për Kornizë Afatmesme Buxhetore, qoftë për buxhetin e vitit të ardhshëm.

Kryesuesi i Komiteti, theksoi, urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës për shqyrtim në Kuvend, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se nga 8 anëtarë/e të Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, me 8 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim Korniza Afatmesme Buxhetore - KAB e Komunës së Podujevës për vitet 2026 /2028.

2. Propozim vendimi për shtim të buxhetit dhe kod të ri.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, sa i përket kësaj pike të rendit të ditës bëhet fjalë për kodin “Furnizim me mekanizëm bujqësor” pra do të thotë në kuadër të buxhetit që është i miratuar për mekanizmin bujqësor, mirëpo kjo vlera shtesë prej 42.857.00€ është shumë e planifikuar nga participimi i qytetarëve kështu që kërkojmë për arsyeje procedurale pra në bazë të rregullores që bëhet participimi i fermerëve për të bartur këto fonde Ministria e Financave na obligon që të merret vendimi në Kuvend Komunal kështu që kërkoj që të kaloj për diskutim në Kuvend.

znj.Sebastina Vokrrri, theksoi, në emër të grupit të LVV e përkrahim propozim vendimin për shtim të buxhetit dhe kod të ri furnizim me mekanizëm bujqësor në vlerë prej 42,857.00€ nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, më bëri përshtypje mekanizmi bujqësor sepse ishte aty një dhe e shikova që ishte prodhim i Serbisë, kurse në të kaluarën Lëvizja Vetëvendosje na ka lodhur duke thënë duaje tënden. Unë një herë kam rastisur duke ardhur nga puna një ish anëtar i Kuvendit e kam parë vetë duke e zbritur njërin nga kamioni që ka pas të ngarkuar pijen Coca-Cola ku shoferi ka qenë Shqiptar dhe ia ka rrotulluar kamionin te vendi i ashtuquajtur “Te Kulina”, tash produkti nga Serbia, ku i keni lënë ju këto premtime, sepse në të kaluarën na keni lodhur duke thënë duaje tënden, prandaj sa po shoh unë ma atdhetarë kishim qenë ne se sa ju sepse ju vetëm zhurmë kishit bërë.

z.Naim Çunaku, theksoi, qëndrimi i anëtarëve të Lidhjes Demokratike të Kosovës edhe pse për herë të parë është aplikuar në vitin e fundit të qeverisjes së LDK-së, por në këtë përbërje ku jam unë vazhdimisht jemi kundër participimit të fermerëve me të vetmin qëllim që në një formë bujku fillestar nuk ka mundësi të subvencionohet sepse për çdo subvencion që pretendon, duhet një pjesë të mirë nga buxheti familjar ta merre dhe kështu në një formë kanë dalë në sipërfaqe fermerët tregtar ti quaja ashtu, në fakt jo të gjithë por një pjesë e madhe e tyre që din ta paguajnë atë pjesë të participimit e që nganjëherë shkon shumë shtrenjtë dhe po sa ta merr subvencionin e hedh në treg at subvencion që e ka përfituar. Pra nuk jemi duke e ndihmuar bujkun dhe në këtë kuptim Lidhja Demokratike e Kosovës është për subvencionimin e fermerëve gjithëherë, por jo t’i detyrojmë që të participojnë.

Kryesuesi i Komiteti, theksoi, urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës për shqyrtim në Kuvend.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 7 vota Për, 1 votë Abstenim dhe asnjë votë Kundër, nga anëtarët/et e Komitetit sa ishin prezent në sallë, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim ky propozim vendimi, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

3. Informatë për aktivitetet e Këshillit Komunal Për Siguri në Bashkësi –KKSB për vitin 2024.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, në mungesë të drejtorit i cili do ta bënte paraqitjen e këtij raporti, materialin e kësaj informate besoj e keni marrë me kohë dhe kërkoj që kjo pikë të kaloj për diskutim në Kuvend.

z.Naim Çunaku, theksoi, kur e filluam mbledhjen e KPF-së diskutuam për këto pika të cilat po janë të përgatitura, vetëm po ia rikujtoi që të gjithë anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa këtu kanë dhënë një zotim publik në mes nesh e që kanë të drejtë t’i bien pishman tani siç i kanë ra disa herë, mirëpo pikat që do të trajtohen në Kuvend Komunal dhe ato që nuk kanë material si dhe ai që duhet të prezantoj në Kuvend nuk e sheh të arsyeshme para organit të Komitetit për Politik dhe Financa t’i prezantoj, kemi pasur një marrëveshje që të mos votohen, mirëpo fjalët t’i shohim sa ne i mbajmë.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, drejtori i DBF-së nuk dha ndonjë arsyeje se pse nuk ka ardhur drejtori përkatës për prezantimin e kësaj pike sepse ai është koordinator edhe pse ai Këshill vetëm janë duke marr para së koti sepse asgjë nuk janë duke bërë, pra asnjë anëtar i KKSBB. Disa pika vetëm janë duke i kopjuar po i qesin nga një vit në vitin tjetër, pra asnjë lëvizje nuk është bërë, përndryshe ne votojmë që kjo pikë të kalojë në Kuvend dhe besoj që drejtori përkatës nesër është në mbledhje dhe e paraqet këtë informatë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim që të rekomandohet për shqyrtim në Kuvend.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 6 vota Për, 2 vota Abstenim dhe asnjë votë Kundër nga anëtarët/et e Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim kjo Informatë, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

4. Rishqyrtim i Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-016/01-0022129/25 të datës 18.04.2025 për ndryshimin dhe plotësim të përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa.
-Kërkesa e MAPL-së nr.020-2/8 datë 30.05.2025.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, ky vendim është kthyer në rishqyrtim për arsyeje se zëvendësimin e znj.Drita Pajazitit e kemi propozuar që të zëvendësohet me z.Xhevdet Maloku, por ky i fundit është mashkull dhe ata kanë kërkuar që të respektohet kuota gjinore, kështu që ky vendim kthehet në rishqyrtim dhe nesër Lëvizja Vetëvendosje duhet të propozojë një anëtare të Kuvendit të gjinisë femërore për anëtare në kuadër të KPF-së.

z.Haki Rudari, theksoi, Kryesuesi e dha arsyetimin dhe normalisht që ne Grupi i Lëvizjes Vetëvendosje nesër do të japim propozimin e emrit për zëvendësimin e znj.Drita Pajazitit.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, nuk e di a ju kujtohet por nëse nuk të kujtohet mund ta dëgjosh incizimin se çfarë të kam thënë i nderuar Kryesues para kësaj seance, dhe për shkak tuajin e kam votuar Për.

Pra Grupi i LDK-së ka votuar kundër ndërsa unë kam votuar për, dhe a e din arsyen pse, sepse të tregova që nuk kalon por ti më drejtove me fjalët voto ti se ajo nuk është puna jona, ne e votuam por po dalim keq te Ministria sepse ne duhet të dimë se ekziston kuota gjinore dhe duhet të respektohet.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, po edhe unë e kam sugjeruar por ka qenë vullneti i tyre për këtë propozim, tash e përmirësojmë atë gabim.

z.Naim Çunaku, theksoi, vetëm po e korrigjoj z.Ekrem Rrahmani se Grupi i LDK-së nuk ka marr pjesë në votim sepse ka qenë çështje e Grupit të LVV-së dhe nuk ka dashtë që të interferojë asgjë në vendimin e Grupit tjetër.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush tjetër dëshiron fjalën për këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës për shqyrtim në Kuvend, me rekomandim që emri i anëtares së KPF-së të propozohet nesër në mbledhjen e Kuvendit nga ana e Grupit të LVV-së.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se Njëzëri, me 7 vota Për, nga anëtarët/et e Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim propozim vendimi, sipas Kërkesës së MAPL-së nr.020-2/8 datë 30.05.2025, me rekomandim që emri i anëtares së KPF-së të propozohet nesër në mbledhjen e Kuvendit nga ana e Grupit të LVV-së.

5. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës për vitin 2024.

- Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, theksoi, sa i përket materialit të kësaj pike të rendit të ditës besoj që është i qasshëm edhe në faqen zyrtare të Zyrës Kombëtare të Auditimit, mirëpo këtij raporti i është bashkangjitur edhe Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve, ky Plan është standard dhe janë komentet dhe planet për veprimet tona për zbatimin e këtyre rekomandimeve, andaj nuk dua që të zgjas më shumë dhe kërkoj që të kaloj për diskutim në seancë të Kuvendit.

z.Naim Çunaku, theksoi, nuk do të doja të kemi një raport të Auditorit të përsëritshëm me kualifikim të përsëritshëm, besoj që vetëm kjo fjali flet mjaftueshëm. Edhe kolegu z.Ekrem Rrahmani e përmendi Kontratën Kolektive dhe është e vërtetë e madhe që kësaj radhe dhe në bazë të asaj kush e ka konsultuar raportin e Auditorit të jashtëm e sheh që nuk është vetëm Kontrata Kolektive ajo që e ka bërë një raport të kualifikuar por janë edhe shumë e shumë të gjetura, si dhe në raportin e rekomandimeve janë të gjeturat të mëtutjeshme ku figuron edhe sa prej tyre janë përmbushur.

Për fund mund të them se na lë të kuptohet që në një formë jemi pajtuar me raportin e auditorit, duke thënë le të thotë ai çfarë të dëshiroj por ne i ecim punët tona.

z.Bashkim Sylja, theksoi, dua të shtoj vetëm diçka, nuk e di arsyen pse këtë Planin e veprimit po e sjell së bashku me raportin kur e dimë që këto të gjetura janë duke u përsëritur 3-4 vite radhazi, andaj ju pyes a ka mundësi që të merret ndokush me këtë dhe të përmirësohet të paktën një prej tyre, të paktën këto pasuritë që po janë më pak se 1000 € a nuk ka mundësi të futen në sistem apo çfarë.

Pra të paktën diçka të ndryshohet që 4 vite sepse të njëjta të gjetura, i njëjti komision për zbatimin e kësaj dhe në fund asgjë e re.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, meqë e përmenda Kontratën Kolektive, në një emision në TV ishte e ftuar krye-Auditorja e cila theksoi që Komunitat po mundohen të arsyetohen për Kontratën Kolektive por ajo është vetëm njëra nga pikat, pra edhe po ta heqim Kontratën Kolektive prapë raporti është i kualifikuar.

Po ashtu është edhe një çudi shumë e madhe që e përmendi edhe kolegu z.Bashkim Sylja se në çdo gjetje që e jep në komentin e saj e shkruani pajtohem, mirëpo ajo nuk po përmirësohet.

Unë i kam edhe raportet e viteve të kaluara por raporti i këtij viti është raporti më i keq në histori të Podujevës, në këtë raport 10 herë përmendet fjala “mashttrim”, nëse e keni lexuar ndokush dhe e bënë krahasimin me vitet e kaluara e sheh që është raporti më i keq, pra këto fletë të raportit mjafton vetëm të hiqen dhe dërgohen në prokurori sepse këto janë vepër penale. Se ku jemi duke shkuar ne kështu nuk e di, këtu ose kemi dështuar ne si shoqëri ose po bëhet normalizimi i çdo sendi këtu, sepse vjen raporti me gjetje dhe ne vazhdojmë ashtu sërish, ndërsa në tjetrin vit gjetja del edhe më e madhe e që thënë të drejtën “lakmi po ju marr” për trimëri, madje unë zërin e kam paksa të lartë por në këtë pjesë nuk do të guxoja as të flija në gjumë.

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, theksoi, sa i përket diskutimit për këtë raport sigurisht se do ta bëjmë nesër në Kuvend dhe mos të shpenzojmë kohë sot, mirëpo çështja është që raporti i auditimit është i kualifikuar dhe arsyeja jo vetëm për Komunitat ton por pothuajse për të gjitha komunitet si shkak është keq klasifikimi i që keq klasifikimi ka rrjedh nga Kontrata Kolektive, ndokush mund të thotë që ne po e marrim si arsyetim Kontratën Kolektive por këtë e thotë edhe vetë raporti i auditimit, pra keq klasifikimi ka ndodhur si rezultat i Kontratës Kolektive. Sa i përket çështjes së regjistrimit të pasurive janë çështje teknike të cilat rrjedhin si problematik për gjatë shumë viteve ku është edhe problemi i sistemit të menaxhimit të sistemit ku regjistrimi i pasurive nuk është i mundshëm në institucionet arsimore shembull ta marrim, por edhe çështjet tjera të cilat kanë rrjedhur qoftë nga çështjet të cilat janë teknike kur janë

regjistruar investimet që nuk janë ndryshuar kategoria dhe kodi dhe kjo nënkupton që kualifikimi vjen si rezultat i Kontratës Kolektive.

Edhe një çështje tjetër, Zyra Kombëtare e Auditimit përmes një pilot projekti ka ardhur për auditim në disa Komuna për çështjet të cilat kanë të bëjnë me dhënien e pronave në shfrytëzim, pra auditohet edhe çështjen e dhënieve të pronave në shfrytëzim dhe në asnjë shkronjë raporti i auditimit financiar nuk e konstaton asnjë euro humbje financiare për Komunën e Podujevës, këtu po flas për kompetencë posaçërisht çështjet të cilat kanë të bëjnë me veprimet të cilat lidhen me çështjet financiare, pra do të ishte mirë të gjeni aty se ku raporti i auditimit e konstaton qoftë edhe 1 euro humbje buxhetore të Komunës së Podujevës si rezultat i veprimit të Komunës, pra nuk konstaton asgjë dhe nuk ka asnjë vepër të natyrës së asaj të cilën po e thotë z.Ekrem Rrahmani. Ky është konstatim i raportit të auditorit dhe në diskutimet që ne i bëjmë me Zyrën Kombëtare të Auditimit sepse kur vjen raporti i auditimit si draft pastaj ne i bëjmë komentet dhe diskutimet, nuk është konstatuar asnjë çështje të tillë apo humbje buxhetore, përndryshe janë 22 Komuna që raporti i auditimi i'u ka dal i kualifikuar, ndërsa atyre Komunave që nuk i'u ka dal raporti i kualifikuar është si rezultat i asaj që çështja që ka të bëjë me Kontratën Kolektive vendimet gjyqësore janë ekzekutuar më herët, shembull deri në vitin 2023 kurse për vitin 2024 i'u kanë mbetur shumë e vogël nga Kontrata Kolektive, kjo është e vërteta, të gjeturat janë këto që janë, krejt të gjeturat që janë të natyrës teknike administrative, pra nuk ka asnjë euro humbje këtu.

z.Ekrem Rrahmani, theksoi, unë më së paku do të doja që në Komunën e Podujevës të kem replikë me drejtorin e DBF-së, i kam arsyet e mija pse, mirëpo auditori nuk thotë i ke marr parat apo si ke marr parat, por e thotë që i është dhënë kontratë kompanisë pa i plotësuar kushtet dhe unë mendoj që kjo është e njëjtë. Pastaj tjetra është që u janë vonuar parat kompanive deri në 200 ditë, janë vonuar lëshimi i lejeve nga 300 ditë, pra nuk thotë raporti që ti apo dikush tjetër keni marr 1 ose 2 euro, mirëpo keqpërdorimet janë këto dhe unë i theksova, por edhe nesër në seancën e Kuvendit do t'i paraqes para të gjithëve.

Më herët e theksova se në këtë raport 10 herë përmendet fjala mashtrim, tentim mashtrim, nëse nuk është ashtu që përmendet kjo fjalë 10 herë unë i marr tani letrat dhe dal nga këtu dhe nuk më sheh askush këtu, prandaj e përsëris atë që në raport nuk thuhet shembull i ke marr eurot, por kështu i'a jap kompanisë punën që nuk e meriton dhe këto janë të gjitha të shkruar i nderuar drejtor i DBF-së, besoj i ke lexuar.

Unë nuk besoj që ky raport është për t'u krenuar siç po thua ti, nesër nëse më lejoni do ta sjell incizimin se çka thotë krye-auditorja në emision që Komunitat janë duke u fshehur pas Kontratës Kolektive por nuk është e vetmja arsyeje që raporti i auditimit del i kualifikuar sepse ka shumë gjetje tjera, kurse ti drejtor që e kundërshton auditorin është çështje jotja por unë do ti them vetëm ato që shkruajnë aty, siç e theksova që në 10 vende është e shkruar fjala mashtrim, ti po thua jo.

Pastaj ky raport thotë që i ke jap kontratë kompanive që nuk e kanë merituar për çka nuk e di se si po guxon komisioni të bëjë këtë punë kështu, por tash edhe kompanitë tjera po frikohen të ankohen sepse një çështje e bëra të madhe për shkollën Ekonomike që është ankuar dhe tash i'a kam bërë një tjetër "Penall" të mirë atij sepse pastaj e mori punën për çështjen e kulturës, po ashtu shkollën në fshatin Bradash, pra i di të gjitha këto punë sepse me këto punë merrem që 25 vite. Mirë nuk është i nderuar drejtor por ti po nisësh nga vetvetja që nuk i merr parat, kurse dikush kontratat që po i jap atyre për të punuar pa i plotësuar kriteret nuk e bënë për ti dhënë parat, por për t'i marr, kurse ti drejtor ndoshta po nisësh nga vetja, është një thënie ku thuhet "me metër tënde mos i mat të tjerët".

z.Naim Çunaku, theksoi, asgjë tjetër mos të ketë ai raport vetëm është i një institucioni më kredibil në Republikën e Kosovës për të monitoruar dhe hetuar se si menaxhohet buxheti i institucioneve të Republikës së Kosovës me ligjet e aplikueshme në Kosovë e që quhet Auditori i Jashtëm, pa politikë dhe i ndërtuar nga Kuvendi i Kosovës. E dimë se si e zhvillon ai veprimtarin, sa mostra i merr sepse nëse i hyn gjithë buxheti ku ta dim se çfarë del, por të gjitha paragjykimet po i lë unë si anëtar i Kuvendit dhe si anëtar i Komitetit për Politikë dhe Financa, por i pyes koleget dhe kolegët e mi që janë ulur në këto ulëse

të Kuvendit Komunal se cili është roli jon dhe në raport të Auditorit e ke një konstatim më shumë se një herë që buxheti i Komunës së Podujevës për këtë vite fiskal është menaxhuar pa vendim të Kuvendit, që është dashtë të jetë nga institucioni më i lart i Komunës pra Kuvendi Komunal, pra të kapërcejnë procedurat që e theksova në fillim demokracinë, duhet ta kuptojmë si proces, procedurë dhe ligj, por që është anashkaluar Kuvendi Komunal, jemi anashkaluar ne të gjithë dhe nuk e di se a ka ndonjë gjë më të madhe në demokraci kur institucioni i cili është i ndërtuar për monitorim, kontroll, mbikëqyrje, aprovim dhe miratim të buxhetit kurse Ekzekutivi nuk e vë në vesh hiç, përndryshe vazhdoni kështu sa t'ju shkon. **Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush tjetër është i interesuar për të marrë fjalën lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që të rekomandohet për diskutim dhe shqyrtim në Kuvend.

Pas votimit, Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se Njëzëri me 7 vota Për, nga anëtarët/et e Komitetit sa ishin prezent në mbledhje, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim, Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Podujevës për vitin 2024, si dhe njëkohësisht edhe Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, si pjesë përbërëse e kësaj pike.

Kryesues i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:05

**Procesverbalin e mbajti;
Osman Bajrami**

**Nr.Prot.01-060/04-0035646/25
Podujevë,
25 qershor 2025**

**Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit
Hilmi Hoxha**